



DILEMAT  
ME TË  
CILAT  
PËRBALLEN  
RINIA

MUHAMMED IBN SALIH  
EL-UTHEJMIN

# **Dilemat me të Cilat Përballen Rinia**

Muhamed ibn Salih el-Uthejmin

## Hyrje

I tërë lavdërimi i takon Allahut. Ne e lavdërojmë dhe e madhërojmë Atë. Prej Tij kërkojmë ndihmë dhe falje dhe Atij i kthehemi. Kërkojmë strehim nga e keqja brenda nesh dhe prej veprave tona të këqija. Atë që Allahu e udhëzon, askush s'mund ta humbë; atë që Allahu e humb, askush s'mund ta udhëzojë. Dëshmoj se s'ka të denjë për adhurim përveç Allahut, i Cili është një, dhe s'ka ortak. Dëshmoj se Muhamedi, salallahu alejhi ue selam, është robi dhe i Dërguari i Tij. Allahu i dhuroftë *Durud* (bekimet e Tija më të mira) atij dhe familjes së tij, si dhe shoqëruesve dhe atyre të cilët i pasuan ata me shkëlqesi.

Është një kënaqësi e posaçme për mua që t'ua prezantoj vëllezërve të mi një problem mjaft serioz, jo vetëm për

shoqërinë Islame por për çdo shoqëri, dhe ky është problemi me të cilën përballen të rinjtë e kësaj epoke. Zemrat e rinisë janë të sëmura me probleme psikologjike, të cilat nganjëherë i bëjnë ata të paretshëm me jetën, dhe ata e shpenzojnë energjinë e tyre duke u përpjekur që të lirohen nga këto vështirësi dhe ta largojnë këtë dhimbje. Largimi i vështirësisë kurrë s'do të zë vend, përveç me Din (fe) dhe me karakterin në të cilin gjendet forcimi i shoqërisë dhe përmirësimi i kësaj bote dhe Jetës së Përtëjme. Me këtë (fe dhe karakter), do të zbresin mirësia dhe bekimet ndërsa e keqja dhe fatkeqësitë do të përfundojnë.

Vendet nuk përparojnë, përveç me ndihmën e qytetarëve të vet dhe feja nuk përfiton, përveç me pasuesit e vet. Kur pasuesit e Islamit të ngrihen për

të, Allahu do t'i ndihmojë ata pavarësisht se sa armiq i kanë ata. Allahu i Madhërishëm thotë:

“O ju që besoni, nëse ju e ndihmoni kauzën e Allahut, Ai do t’ju ndihmojë juve dhe do t’ua forcojë këmbët tuaja (kundër armikut tuaj), dhe ata që mohuan - të mjerët ata; veprat e tyre janë të kota.” [47:7,8]

Nëse feja s’mund të forcohet përveç me pasuesit e saj, atëherë është e domosdoshme për ne, pasuesit e Islamit dhe bajraktarët e saj, që së pari ta forcojmë vetët tona ashtu që të bëhemi të denjë për udhëheqje dhe udhëzim. Është imperativ që të mësojmë nga Libri i Allahut (Kur’ani) dhe Sunetit i të Dërguarit të Tij, salallahu alejhi ue selam, gjë që do të na pajis për fjalim, vepër, udhëzim dhe thirrje. Kjo do të na mundësoj që

t'i bartim armët e udhëzimit të Islamit te të gjithë ata të cilët e kërkojnë të vërtetën dhe po ashtu të përdoren kundër të gjithë atyre të cilët e kërkojnë të pavërtetën.

Pastaj, është e domosdoshme për ne që ta zbatojmë tërë atë që e kemi mësuar nga Kur'ani dhe Suneti, në bazë të Imanit (besimit), bindjes, dhe sinqeritetit. Karakteristika jonë s'duhet të jetë vetëm ajo e të folurit, sepse nëse të folurit nuk përkrahet me vepër, efektet e saja s'do të shtrihen përtej folësit dhe kjo e folur do të ketë efekt të kundërt:

“O ju që besoni, pse e flitni atë të cilën nuk e punoni. Është shumë e urryer në shikimin e Allahut që ju ta thoni atë që nuk e praktikoni.” [61:2-3]

Është më se e përshtatshme për ne që të nisemi në fillim dhe të mendojmë

për rininë tonë dhe mendimet e veprat e tyre, ashtu që t'i shtojmë ato të cilat janë të mira dhe t'i përmirësojmë ato të cilat janë të gabuara. Sepse, rinia e sotme janë njerëzit e së nesërme dhe ata janë fundamenti në të cilin populli i ardhshëm do të ngrihet. Mu për këtë shkak, teksti i Sheriatit (Ligjit Islamik) inkurajon që rinisë t'i japim interesimin që i takon dhe t'i drejtojmë ata në atë që është e mirë dhe korrekte. Ata janë baza e Umetit prej të cilëve do të ndërtohet e ardhmja e tij, dhe nëse reformimi i tyre është i bazuar në shtyllat e forta të fesë dhe karakterit, do të ketë një të ardhme të shkëlqyer për këtë Umet, nëse do Allahu.

## **Një vështrim i shkurtër në rininë**

Nëse e kontrollojmë rininë për së afërmi, për ne do të jetë e mundur që të konkludojmë se rinia në përgjithësi është tri llojesh: Rinia e udhëzuar drejt, rinia e devijuar apo perverse, dhe rinia e cila është në konfuzion (në mes të mirës dhe së keqes).

### *Lloji i parë*

Rinia e udhëzuar drejt janë: Rinia e cila beson bindshëm në tërë atë që nënkupton Kelimeti (dëshmia/shahadeti). Ata bindshëm besojnë në Fenë e tyre. Imani (Besimi) është i dashur për ta dhe ata janë të kënaqur dhe të mjaftuar me Imanin e tyre. Ata e konsiderojnë mësimin e Islamit si dobi, ndërsa privimin nga



ajo si një humbje të madhe.

Rinia e cila e adhuron Allahun singerisht. Ata e adhurojnë vetëm Allahun, i Cili s'ka ortak.

Rinia e cila pason të Dërguarin e Allahut, Muhamedin, salallahu alejhi ue selam, praktikisht në të folurit e tyre dhe vepra, sepse ata besojnë se ai është i Dërguar i Allahut dhe udhëheqës i të gjithë të dërguarve.

Rinia e cila e falë namazin në mënyrë të përsosur, sipas mundësive më të mira të tyre. Sepse, ata besojnë në dobinë dhe vlerën fetare, tokësore dhe sociale, që gjindet në namaz dhe pasojat e rrezikshme nga neglizhimi i namazit për individin dhe popullin.

Rinia e cila u jep plotësisht zekatin atyre të cilët e meritojnë atë, sepse ata besojnë se Zekati i përmbush nevojat e

Islamit dhe se ai është njëra prej pesë shtyllave të Islamit.

Rinia e cila agjëron gjatë muajit të Ramazanit. Ata e ndalojnë veten e tyre nga dëshirat dhe mallin, qoftë verë apo dimër, sepse ata besojnë se veprat janë për kënaqësinë e Allahut. Kështu, ata i dhënë përparësi asaj e cila e kënaq Allahun mbi atë të cilën ata e dëshirojnë.

Rinia e cila ekzekuton detyrën obligative të Haxhit (Pelegrinazhit) në shtëpinë e shenjtë të Allahut, sepse ata e duan Allahun. Ata e duan Shtëpinë e Allahut dhe kanë dëshirë që të shkojnë në vendet e mëshirës dhe faljes së Tij, dhe të bashkëpunojnë me vëllezërit e tyre të cilët vijnë në këto vende.

Rinia e cila beson në Allahun, i Cili është Krijuesi i tyre dhe krijuesi i

qiejve dhe i secilit. Sepse, ata shohin prej shenjave të Allahut atë, e cila nuk lë kurrfarë dyshimi në ekzistencën dhe qenien e Allahut, qoftë edhe vetëm për një moment. Ata shohin në këtë gjithësi të gjerë unike, në formën dhe sistemin e gjithësisë, atë e cila qartë tregon në ekzistencën e krijuesit të saj dhe fuqinë totale dhe urtësinë e plotë të Tij, sepse s'është e mundur për këtë gjithësi që të shfaqet në ekzistencë vetvetiu, e as që është e mundur për të që të shfaqet rastësisht në ekzistencë. Arsyeja për këtë është se gjithësia ishte e paqenë para se të nxirrej në ekzistencë, dhe ajo që është e paqenë s'mund të sjellë diçka në ekzistencë, sepse ajo vetë është inekzistente.

S'është e mundur që gjithësia doli në ekzistencë rastësisht, sepse ajo ka një sistem unik të organizuar mirë, i cili nuk ndërron apo luhartet nga

procedura e paracaktuar për të.

“Ju kurrë s’do të gjeni ndonjë devijim në sistemin e Allahut.” [33:62]

“Ju kurrë s’do të gjeni ndonjë ndryshim në sistemin e Allahut.” [35:43]

“Ju s’do të shihni në krijimin e Hirplotit ndonjë mungesë harmonie. Pra, kthejeni shikimin tuaj prapë, a shihni ndonjë thyerje? Pastaj kthejeni shikimin tuaj prapë, për herë të dytë; shikimi juaj do t’ju kthehet i topitur dhe në një gjendje të lodhur.” [67:3- 4]

Fakti se kjo gjithësi e ka një sistem unik të organizuar mirë, e parandalon të qenit e ekzistencës së saj rastësi. Ajo që është e rastësishme në ekzistencë, po ashtu do ta ketë një sistem të rastësishëm i cili ka gjasa të ndryshojë

apo të çrregullohet në një periudhë të shkurtër kohore.

Rinia e cila beson në engjëjt e Allahut, sepse Allahu ka dhënë informacione në lidhje me ta (engjëjt) në librin e Tij dhe i Dërguari, salallahu alejhi ue selam, ka dhënë informata në lidhje me ta në Sunet (traditë). Kur'ani dhe Suneti i shpjegojnë kualitetet e tyre, adhurimin e tyre dhe punët e tyre ndaj të cilave ata mbahen të paepur për të mirën e krijimit. Kjo qartë thekson ekzistencën e engjëjve.

Rinia e cila beson në Librat e Allahut. Allahu ua shpalli këto libra të Dërguarve të Tij si një burim të udhëzimit për krijimin për në rrugën e drejtë. S'është e mundur për mendjen e njeriut që ta kuptojë ngatërresën e adhurimit dhe jetës shoqërore, përveç me librat e Allahut.

Rinia e cila beson në peygamberët dhe të dërguarit e Allahut, të cilët Allahu ia ka dërguar krijimit të Tij që t'i thërret ata në të mirën dhe t'i urdhërojë ata për të mirën dhe t'i ndalojë ata nga e keqja, ashtu që njerëzit të mos kenë ndonjë dëshmi kundër Allahut pasi që Ai t'i ketë dërguar peygamberët. I Dërguari i parë qe Nuhu, alejhi ue salam, kurse i dërguari i fundit qe Muhamedi, salallahu alejhi ue salam.

Rinia e cila beson në Ditën e Fundit, në të cilën njerëzit do të ringjallen pasi të vdesin, ashtu që ata të shpërblehen për veprat e tyre. Kushdo që e vepron një të mirë sa grimca e atomit, do ta korrë atë; kushdo që bën keq sa grimca e atomit, do ta korrë atë. Kjo është pasoja e kësaj bote, përndryshe çfarë do të ishte dobia e jetës dhe çfarë

është dobia e jetës po që se nuk ka ditë për krijimin në të cilën bërësi i të mirës do të shpërblehet për të mirën e tij, dhe autori i së keqes të dënohet për të keqen e tij.

Rinia e cila beson në paracaktimin e së mirës dhe të keqes. Kështu, ata besojnë se çdo gjë është vendim i Allahut dhe paracaktimi hyjnor i Tij. Kjo është pavarësisht besimit të tyre në shkaqet dhe pasojat e ndërlidhura të tyre, dhe se për të dyjat, të mirën dhe të keqën, ka mënyra.

Rini e cila ngjitet për këshillën e Allahut, të Dërguarit të Tij, udhëheqësve të Muslimanëve, dhe masës së përgjithshme. Ata bashkëveprojnë me Muslimanët me çiltërsi dhe transparencë – mënyra e cila është e obliguar për ta. Ata nuk çorientojnë, mashtrojnë e as që fshehin

ndonjë gjë.

Rinia e cila thërret në Allahun me mendjehollësi/depërtim të thellë, në pajtim me mënyrën të cilën Allahu e ka parashtruar në librin e Tij.

“Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të shëndoshë, dhe debato me ta në mënyrë të përshtatshme.” [16:125]

Rinia e cila urdhëron në të mirën dhe ndalon nga e keqja, sepse ata besojnë se në këtë gjendje suksesi i një populli.

“Ju jeni populli më i mirë i ngritur për udhëzimin e njerëzimit. Ju urdhëroni për të mirën dhe ndaloni nga e keqja, dhe ju keni besim të plotë në Allahun.” [3:110]

Rini e cila përpiket në ndryshimin e së keqes në mënyrën e vendosur nga i



Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selam: “Kushdo prej jush që e sheh një të keqe, ai duhet ta ndryshojë atë me dorën e tij. Nëse s’ka fuqi që ta bëjë këtë, atëherë ai duhet ta ndryshojë atë me gjuhën e tij. Nëse s’ka mundësi as për këtë, atëherë ai duhet ta ndryshojë atë me zemrën e tij (duke planifikuar çrrënjosjen e kësaj të keqeje).” (Hadith)

Rini e cila e flet të vërtetën dhe e pranon të vërtetën, sepse e vërteta çon në të mirën dhe e mira çon në Parajsë. Personi do të vazhdojë të jetë i sinqertë dhe ta pasojë të vërtetën derisa ai e dëshiron për vëllain e tij (Musliman) atë që e dëshiron për vete.

Adoleshenti i cili është i ditur për përgjegjësitë e veta ndaj Allahut dhe popullit të tij. Ai gjithmonë përpiqet për të mirën e fesë së tij, popullit dhe atdheut të tij, duke qëndruar larg

egoizmit dhe larg nga të dhënit përparësi të mirës personale në llogari të së mirës së të tjerëve.

Adoleshenti i cili përpiqet për kënaqësinë e Allahut dhe me ndihmën e Allahut në rrugë të Allahut. Ai përpiqet me sinqeritet pa mburrje apo dëshirë për reputacion. Ai godet me ndihmën e Allahut pa u krekosur dhe pavarësisht nga fuqia dhe mundësia e tij. Ai përpiqet në rrugë të Allahut për ngritjen e fesë së tij pa i tejkaluar kufijtë dhe pa shkujdesje. Ai përpiqet me gjuhën e tij, dorën dhe pasurinë në mënyrën të cilën e kërkojnë nevojat e Islamit dhe Muslimanëve prej tij.

Rini e cila ka karakter dhe fe, kështu që ata janë më karakter të rafinuar, fe, të butë, liberalë, me mendje të fisnikëruar, me zemër të pastër, të qëndrueshëm, dhe të vendosur. Ata

nuk e humbin çfarëdo rasti e as që lejojnë që dhembshuria t'ua mbizotërojë intelektin dhe nevojën për reformim.

Adoleshenti i cili është sistematik. Ai punon me urtësi dhe qetësi, duke qenë i vendosur dhe i shkëlqyer në punën e tij. Ai nuk e humb asnjë rast, por në vend të kësaj preokupohet me punë e cila është e dobishme për të dhe popullin e tij.

Së bashku me këtë, ky adoleshent e ruan fenë e tij, karakterin dhe sjelljen. Kështu, ai është skajshmërisht i larguar prej këtyre kualiteteve të cilat e kundërshtojnë këtë, si kufri (mosbesimi), femohimi, padrejtësia, mosbindja, karakteri i ulët dhe raportet e këqija reciproke.

Këto lloje të rinisë janë krenari e popullit dhe simbol i prosperitetit dhe fesë së tij. Këta janë rini e cila do ta arrijë të mirën e kësaj bote dhe Jetës së Përtejme. Ata janë rinia e cila shpreson se Allahu me mëshirën e Tij, do të korrigjojë prishjen në mesin e Muslimanëve dhe do ta ndriçojë shtegun shpirtëror të kërkuesit të së vërtetës.

### *Lloji i dytë*

Lloji i dytë i adoleshentit është ai i cili është i degjeneruar në besimin e tij, i papërgjegjshëm për sjelljen e tij, vetë i devijuar, i zhytur në ves; ai nuk e pranon të vërtetën prej askujt e as që përmbahet nga e pavërteta, dhe ai është vetiak në sjelljen e tij. Ai është adoleshent i cili është kokëfortë. Ai nuk i dorëzohet të vërtetës e as që e refuzon të pavërtetën. Ai nuk kujdeset

për neglizhimin e tij ndaj të drejtave të njerëzve e as për të drejtat e Allahut. Ai është adoleshent konfuz i privuar nga objektiviteti në të menduarit dhe sjelljen e tij. Gjithashtu, atij i mungon balancimi në të gjitha çështjet e tija.

Adoleshenti i cili është i fryrë me mendimin e vet, thua se e vërteta rrjedh nga gjuha e tij. Ai, në mendimin e vet, është i pastër nga fatkeqësitë derisa të tjerët janë burim i gabimeve dhe rrëshqitjeve përderisa ata e kundërshtojnë mendimin e tij.

Adoleshenti i cili është larguar nga rruga e drejtë në fenë e tij dhe normat e pranuar të sjelljes. E keqja e kësaj sjelljeje i është bërë joshëse atij, prandaj ai e konsideron atë virtyt. Ai është humbësi më i madh në lidhje me veprat e veta. Këta janë ata, përpjekjet e të cilëve janë humbur në këtë jetë,

derisa ata supozojnë se janë duke bërë mirë.

Ai është ogur djallëzor për veten e tij dhe një fatkeqësi për shoqërinë e tij; ai i cili e shtyen popullin e tij drejt nivelit më të ulët. Ai është pengesë në mes popullit të tij dhe bujarisë e respektit të tyre, ndikim vdekjeprurës, i vështirë që të trajtohet – përveç nëse do Allahu. Allahu ka pushtet mbi çdo gjë.

### *Lloji i tretë*

Lloji i tretë i adoleshentit është ai i cili është konfuz dhe i dyshimtë. Ai e njeh të vërtetën dhe është i kënaqur me të. Ai jeton në një shoqëri të mbrojtur, por dyert e së keqes i janë hapur atij nga çdo drejtim. Kjo ka krijuar dyshim në besimet e tija, devijim në sjelljen e tij, dobësi në të vepruarit e tij, një bastisje nga praktikrat e njohura dhe një influks

të rrenave të ndryshme. Kështu, ai është në mendime dhe hulumtim të brendshëm të përhershëm. Të kundërshtuarit e këtij influksi apo lëvizjeje (të së pavërtetës) është pasiguri. Ai nuk e di se a gjendet e vërteta në ideologjitë të cilat mbizotërojnë apo në rrugën e paraardhësve të devotshëm të tij dhe në shoqërinë e ruajtur të tij. Kështu, pra, ai është në dyshim – nganjëherë ai pajtohet që ta preferojë njërin anë dhe nganjëherë tjetrën, sipas fuqisë së influksit të këtyre mendimeve.

Ky lloj i adoleshentit është pasiv në jetën e tij. Ai ka nevojë për forcë joshëse, e cila do ta udhëzojë atë drejt bashkëmbylljes së të vërtetës dhe shtegut të së mirës. Sa do të ishte lehtë sikur Allahu ta përgatiste një person i cili e thërret atë në të mirën, i cili është i urtë, i ditur dhe me qëllime të mira!

Ky lloj i adoleshentëve gjendet me shumicë. Ata e arrijnë një njohuri sipërfaqësore të edukatës Islame por në anën tjetër ata marrin shumë më shumë dituri sekulare, e cila është në kundërshtim me bazat e fesë në realitet apo në supozimet e saja. Kështu që ata janë të pambrojtur në mes dy kulturave. Për ta është e mundshme që ta fitojnë lirinë nga kjo paaftësi, duke e vendosur vetveten mbi edukimin Islamik dhe duke e marrë këtë edukim nga burimet origjinale të tija – Librin e Allahut (Kur’ani) dhe Sunetin (traditat) e Muhamedit, salallahu alejhi ue selam, afër Dijetarëve të devotshëm – dhe kjo s’është vështirë për ta.



## **Devijimi i rinisë dhe problemet e tyre**

Arsyet për devijimin dhe vështirësitë e rinisë janë të shumta dhe ato ndryshojnë. Njeriu, gjatë periudhës së rinisë, në një masë të madhe është në një proces të zhvillimit trupor, proceseve mendore dhe mendjes, sepse kjo është etapa e rritjes, gjatë së cilës ai i nënshtrohet ndryshimeve rapide. Në këtë etapë është me rëndësi të madhe që mjetet e vetëkontrollimit të janë të përgatitura për të, të çiftëzuara me udhëheqje të urtë, që ta drejtojnë atë për në rrugën e drejtë.

Prej shkaqeve të rëndësishme për këtë prapakthim janë këto që vijojnë:

### *Kotësia:*

Kotësia është pafuqi e cila i vret proceset mendore, mendjen dhe fuqinë e trupit, sepse trupi përherë ka nevojë për lëvizje dhe punë. Kur trupi është në kotësi, mendimet bëhen të topitura dhe mendja dobësohet, lëvizjet trupore dobësohen dhe insinuatat djallëzore dhe mendimet e këqija formohen në zemër. Shumë herë krijohet një qëllim i neveritur si rezultat i kësaj shtypjeje, e cila ishte pasojë direkte e kotësisë. Shërimi nga ky problem është ajo se adoleshenti duhet të përpiqet në arritjen e punës e cila i përshtatet atij, siç është leximi, biznesi, apo të shkruarit e cila pastaj bëhet pengesë në mes tij dhe kotësisë së tij. Është e domosdoshme që ai të bëhet anëtar stabil i shoqërisë, duke punuar në shoqërinë e tij për vetveten dhe për të tjerët.

*Largimi dhe ftohja në mes rinisë dhe anëtarëve të vjetër të familjes apo në mes rinisë dhe të tjerëve:*

Ne shohim disa të vjetër të cilët e dëshmojnë devijimin në rininë e tyre por ata ngurrojnë, janë të dekurajuar dhe të paaftë që t'i forcojnë ata dhe të pavarur prej reformimit të tyre. Rezultat i kësaj është urrejtja ndaj kësaj rinie, ndarja prej tyre dhe qëndrimi indiferent ndaj gjendjes së tyre, qoftë gjendja e tyre ajo e devotshmërisë apo e çoroditjes. Nganjëherë ata marrin vendim në lidhje me të gjithë rininë, i cili shpjegohet me një përshtypje boshe të rinisë në përgjithësi. Kjo e ndanë komunitetin, me ç'rast rinia dhe të vjetrit e tyre fillojnë të shikohen ndërmjet veti me sytë e përbuzjes. Kjo është njëra prej rreziqeve më të mëdha që mund ta përfshijë shoqërinë njerëzore. Shërimi për këtë problem

është ajo se rinia dhe të vjetrit e tyre duhet të bëjnë përpjekje që ta çrrënjosin këtë ftohje në mes tyre dhe t'i besojnë secilit, sepse shoqëria, bashkë me rininë dhe të vjetrit e saj, është sikurse një trup; kur një pjesë e tij shpërbëhet, ajo çon në shpërbërjene tërë trupit. Është obligim për të vjetrit që ata të mendojnë thellë për përgjegjësitë në lidhje me reformimin e rinisë dhe ta largojnë këtë dëshpërim infektues nga zemrat e tyre, sepse Allahu ka pushtet mbi çdo gjë. Sa njerëz të prishur Allahu nuk i ka udhëzuar, e që më pas ata u bënë fenerë të udhëzimit dhe thirrës në reformë? Është me rëndësi për rininë që ata të ushtrojnë respekt, konsideratë për mendime dhe pranim të udhëzimit nga të vjetrit e tyre, të cilët i kanë përjetuar realitetet e jetës të cilat këta të rinj nuk i kanë përjetuar. Kur urtësia e të vjetërve të takohet me

forcën e rinisë, shoqëria do të prosperojë me vullnetin e Allahut.

*Bashkimi me njerëz të devijuar e të prishur dhe shoqërimi me ta.*

Kjo ka ndikim të madh në mendjen, të menduarit dhe mënyrat e rinisë. Për këtë arsye, Pejgamberi, salallahu alejhi ue salam, është transmetuar të ketë thënë: “Personi është në fenë e shokut të tij. Pra, secili nga ju duhet të kujdeset në çështjen se kë e shoqëron ai.” Ai, salallahu alejhi ue salam, po ashtu tha: “Shembulli i shokut të keq është si shembulli i farkëtarit i cili përdorë furrën: ose ju do t’i digjni teshat në shoqërimin e tij, ose do të përjetoni një kundërmim të rëndë.” (Hadith) Shërimi për këtë problem është ai se adoleshenti duhet të zgjedhë për shoqërimin e tij ata të cilët janë të mirë dhe inteligjentë, ashtu që ai të përfitojë nga virtyti i tyre,

mënyrat e reformuara dhe inteligjenca. Ai duhet ta vlerësojë gjendjen dhe reputacionin e tyre para se t'i shoqërojë ata. Nëse ata janë njerëz të karakterit, virtytit, fesë korrekte dhe me reputacion të mirë, atëherë shoqëroni ata. Nëse ata nuk i posedojnë këto kualitete, atëherë është obligim që të largohen prej tyre, që të mos mashtrohen me të folur të ëmbël dhe paraqitje të mirë të jashtme. Kjo është mashtrim dhe devijim. Kjo rrugë përshkohet nga njerëz të këqij që mundohen t'i tërheqin mendjelehtit me qëllim që ta shtojnë turmën e tyre dhe ta fshehin gjendjen e keqe të tyre. Një poet e ka thënë këtë më së miri: Provoji njerëzit kur të kesh qëllimin që t'i shoqërosh ata, shqyrtoji dhe studioji punët e tyre.

*Leximi i retorikës, broshurave dhe revistave të cilat krijojnë dyshim në fenë e personit dhe në besimet e tija.*

Kjo e tërheq personin drejt abrogimit të karakterit virtuoz dhe e çon atë në kufër (mosbesim) dhe ves. Kjo veçanërisht është e vërtetë kur adoleshenti nuk posedon edukim të thellë fetar dhe mendim akut (të mprehtë), me anë të cilit ai mund të dallojë në mes të vërtetës dhe gënjeshtërisë, dobisë dhe dëmit. Leximi i këtyre llojeve të librave plotësisht turbullon, sepse ato ngulitin një kënaqësi të rrejshme në mendjet dhe të menduarit e rinisë pa kufizime. Shërimi për këtë problem është se ai duhet të qëndrojë larg nga këto libra dhe të lexojë libra tjera të cilat do të mbjellin në zemrën e tij dashuri për Allahun dhe të dërguarin e Tij, salallahu alejhi ue selam, realitetin e Imanit dhe veprave të mira. Pa

dyshim se brendësia e tij do ta tërheqë atë në këto libra, të cilat ai i deshi paraprakisht, dhe e bën atë të ndihet i pakënaqur me punime tjera të dobishme. Kjo është e ngjashme me pozitën e atij personi i cili ndeshet me brendësinë e vet që ta vendosë dëgjueshmërinë ndaj Allahut në jetën e tij, por shpirti i tij rebelohet dhe përfshihet në kotësi dhe gënjeshtër. Libri më i rëndësishëm dhe më i dobishëm është libri i Allahut dhe ato të cilat i kanë shkruar dijetarët me transmetim korrekt. Njëlloj edhe Suneti i të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selam, pastaj ajo të cilën njerëzit e diturisë e kanë shkruar duke e nxjerr prej këtyre dy burimeve apo me të kuptuarit e thellë.



*Përshtypja e disa të rinjve se Islami është shkurtim i lirisë dhe përmbajtje e forcës.*

Ata largohen nga Islami duke e konsideruar atë si retrograd dhe pengesë në mes atyre dhe progresit. Shërimi për këtë problem është që të hiqet velloja e realitetit të Islamit nga këta të rinj të cilët janë injorantë ndaj realitetit të tij për shkak të popullit të gabuar të tyre, diturisë së pamjaftueshme, apo të dyjave. Islami nuk e kufizon lirinë por ai është rregullator dhe kanalizim korrekt për të, deri në atë masë sa që liria e njërit person nuk ndeshet me lirinë e personit tjetër. Liria e përgjithshme çon në kaos dhe erupsion. Për këtë arsye urdhrat e fesë quhen *Hudud* (kufij). Nëse urdhri është një prej ndalesave, Allahu thotë: **“Ata janë kufijtë e vendosur nga Allahu, mos ju afroni atyre.”** [2:187] Nëse është një prej miratimeve, Allahu Te’ala thotë:

**“Këta janë kufijtë e vendosur nga Allahu, mos i shkelni ata.” [2:229]** Ky është dallimi në mes kufizimit (e cila është përshtypja e disave) dhe kontrollit dhe udhëzimit të cilin e ka vendosur më i Urti, i Gjithëdijsmi Allah, për robërit e vet. Për këtë problem nuk ka bazë, sepse sistematizimi është një realitet në të gjitha fushat dhe njeriu nga natyra është i nënshtruar ndaj këtij realiteti sistematik. Ai është i nënshtruar ndaj presionit të urisë dhe etjes, dhe ndaj sistemit të ushqimit dhe pijes së tij sa i përket kuantitetit, kualitetit dhe llojit, ashtu që ta ruajë trupin e tij dhe shëndetin e tij. Ai në mënyrë të njëjtë i nënshtrohet edhe sistemit të shoqërisë së tij, duke u mbajtur me zakonet e qytetit të tij në banim, veshje dhe modele të transportit. Nëse ai nuk nënshtrohet ndaj kësaj, ai do të konsiderohet si anormal dhe do të

trajtohet në mënyrën në të cilën trajtohen njerëzit e çuditshëm. Jeta plotësisht është nënshtrim ndaj kufijve të specifikuar, ashtu që çdo gjë përparon sipas qëllimit të caktuar të tij. Ky nënshtrim është për rendin e shoqërisë, d.m.th. nënshtrimi i cili është i domosdoshëm për reformimin e shoqërisë dhe parandalimin e anarkisë. Në të njëjtën mënyrë, nënshtrimi ndaj sistemit të Sheriatit nënkupton atë e cila është e domosdoshme për reformimin e popullit. Pra, si mund të mërzhiten njerëzit me të dhe të mendojnë për të se është kufizim i lirisë? Vërtet, kjo është një e pavërtetë e madhe dhe një supozim djallëzor i pa bazë. Në të njëjtën mënyrë, Islami s'është shuarje e aftësive. Ai është një sferë e gjerë për të gjitha forcat. Islami thërret në mendim që njeriu të sodisë, dhe mendja e mendimet e tija të rriten.

Allahu thotë: **“Thuaj: O Muhamed, unë ju këshilloj vetëm në një gjë, që ju të qëndroni nga dy dhe vetëm e pastaj të mendoni.”** [34:46] dhe Allahu thotë: **“Thuaj: O Muhamed, shikoni se çfarë ka në qiej dhe tokë.”** [10:101] Islami nuk e kufizon veten në të thirrurit në soditje dhe në të menduarit e thellë, por i dënon ata që nuk mendojnë, nuk vështrojnë dhe nuk sodisin. Allahu thotë: **“A nuk përfillin ata sundimin e qiejve dhe tokës, dhe gjërat që i ka krijuar Allahu?”** [7:185] Allahu thotë: **“A nuk menduan ata thellë për veten e tyre? Allahu nuk i krijoi qiejt dhe tokën dhe atë çka ka në mes tyre, përveçse me të vërtetën.”** [30:8] Dhe Allahu Te’ala thotë: **“Dhe atij të cilit ne i japim moshë të vjetër, Ne e kthejmë atë prapa në krijim (duke e bërë atë që t’i kthehet dobësisë pas forcës). A nuk mendoni?”** [36:68]

Urdhri për vështrim dhe soditje e hap fuqinë e mendjes dhe mendimeve. Pra, si mund të thonë disa njerëz se ai (Islami) i kufizon mundësitë? E tmerrshme është fjala të cilën e thonë ata; ata vetëm gënjejnë. Islami ka legalizuar për njerëzit e vet të gjitha kënaqësitë në të cilat s'ka dëm për individin, as fizikisht as mentalisht apo shpirtërisht. Islami e ka autorizuar ngrënien dhe pirjen e të gjitha gjërave të pastra: **“O ju që besoni, hani prej gjërave të mira me të cilat Ne u kemi furnizuar dhe falënderoni Allahun.”** [2:172] Allahu thotë: **“Hani e pini e mos shpërdoroni. Ai nuk i do ata që shpërdorojnë.”** [7:31] Islami ka legalizuar të gjitha veshjet sipas kërkesave të urtësisë dhe natyrës: **“O fëmijët e Ademit! Ne kemi krijuar për ju veshje që të fshehim turpin tuaj dhe një paraqitje të shkëlqyer. Po veshja e devotshmërisë është më e**

**mira.” [7:26] Allahu Te’ala thotë: “Thuaj: O Muhamed, kush i ka ndaluar bukuritë (dhuratat) e Allahut të cilat Ai i ka prodhuar për robërit e Tij dhe gjërat e pastra (të cilat Ai i ka prodhuar) si mjete jetese? Thuaj, ato në këtë botë janë për ata të cilët besojnë, dhe vetëm për ta në Ditën e Gjykimit.” [7:32] Ai e ka autorizuar kënaqësinë e gruas me *nikah* (martesë) legjitime: Allahu Te’ala thotë: “Martohuni me gratë të cilat i dëshironi, me dy, tri, apo katër. Por nëse frikoheni se s’do të jeni të drejtë ndaj tyre, atëherë vetëm një.” [4:3] Në fushën e ekonomisë, Islami nuk i ka shuar aftësitë e njerëzve të tij por ka legalizuar për ta të gjitha marrëveshjet e biznesit, të cilat janë të drejta dhe dalin nga lumturia reciproke. Allahu thotë: “Allahu e ka lejuar tregtinë ndërsa e ka ndaluar kamatën.” [2:276] Dhe Ai thotë: “Është Ai i cili e ka bërë**

tokën të drejtueshme për ju. Pra, përshkoni shtigjet e saja dhe hani nga ushqimi me të cilin Ai ju furnizon, dhe Ai është përgjegjës për ringjallje.” [67:15] Dhe Ai thotë, “Dhe kur të përfundojë namazi, atëherë shpërndahuni nëpër tokë dhe kërkoni të mirat e Allahut.” [62:10] Pas tërë kësaj, a është përshtypja apo thënia e disa njerëzve korrekte se Islami i shuan aftësitë?

Problemet të cilat rishfaqen në zemrën e adoleshentit

Dyshimet dhe mendimet djallëzore vazhdojnë të rishfaqen në zemrën e vdekur e cila e kundërshton fenë. Për këtë arsye i është thënë Ibn Mes’udit apo Ibn Abasit (radiallahu anhuma) se Çifutët thonë se ata nuk kanë mendime djallëzore gjatë lutjeve të tyre, d.m.th. ata nuk përjetojnë frikë.

Ai u përgjigj, “Të vërtetën e kanë thënë ata. Çfarë mund të bëjë Shejtani me zemrën e zbrazët?”

Nëse zemra është e gjallë dhe ka vetëm një grimcë Iman në të, shejtani e sulmon atë. Sulmi i tij është i lirë nga butësia dhe ngadalësia. Ai hedh në zemër aso mendime të këqija, të cilat janë të dëmshme për fenë. Është një shkatërrim i madh nëse robi i pranon këto mendime djallëzore derisa Shejtani e nxit atë që të krijojë dyshime në Zotin Tij, fenë dhe besimet. Nëse ai gjen në zemër ndonjë dobësi apo zhgënjim, shejtani e kaplon zemrën e tij derisa ta nxjerrë atë jashtë kufijve të fesë. Sidoqoftë, nëse ai gjen në zemër fuqi dhe vendosmëri, ai shpik një plan të përbuzshëm që ta devijojë robin. Këto mendime djallëzore të cilat shejtani i hedh në të, s’do ta dëmtojnë personin nëse ai e praktikon terapinë e



përmendur nga Resulullahu, salallahu alejhi ue selam, në lidhje me të: Ibn Abas (radiallahu anhu) transmeton se një person erdhi te Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, dhe tha: “Unë kam një ndjenjë të veçantë brenda vetes, saqë të jem prush që digjet është më e dashur për mua sesa ta them atë.” Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, tha: “I tërë lavdërimi i takon Allahut, i cili e ka refuzuar këtë plan d.m.th. i ka dëbuar mendimet e këqija të shejtanit.” (Hadith)

Disa njerëz nga Sahabët (Shoqëruesit) erdhën dhe thanë, “O i Dërguar i Allahut, ne kemi ne brendësinë tonë atë (ndjenja të atilla) që e kaplon secilin prej nesh që të flet për të d.m.th. e ndjen atë si të imponuar që të flet për të.” Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, pyeti: “A e përjetoni edhe ju këtë?” Shoqëruesit u

përgjigjen, “Po.” Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, u përgjigj, “Ky është besimi i vërtetë.” Domethënia e të pasurit besim të vërtetë është se mendimet djallëzore dhe refuzimi juaj i tyre nuk e dëmton Imanin tuaj aspak, por kjo është dëshmi se Imani juaj është i sinqertë dhe s’është ndikuar nga ndonjë humbje.

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, ka thënë: “Shejtani i vjen ndonjërit prej jush dhe thotë: Kush e krijoi këtë? Kush e krijoi këtë?, derisa të thotë: Kush e krijoi Zotin tënd? Kur ai ta mbërrin këtë kufi, kërkoni strehim në Allahun dhe në dhembshurinë e Tij.” (Hadith)

Është thënë në një tjetër hadith në lidhje me situatën e njëjtë. “Ju duhet të thoni: besoj në Allahun dhe të Dërguarit e Tij.” Dhe në një hadith të

ngjashëm që e ka transmetuar Ebu Daud, Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, ka thënë: "Thuaj: "Allahu është një. Allahu është i pavarur. Ai nuk lind e as që është i lindur", pastaj pështyjë lehtas në të majtë tri herë dhe kërko strehim nga shejtani i mallkuar."

Njëherë Sahabët (radiallahu anhum) ia përshkruajtën këtë qëllim Pejgamberit, salallahu alejhi ue selam, për të cilin ai përshkroi shërimin në katër hapa:

Së pari: Asgjësimi i mendimeve të këqija duke iu shmangur atyre dhe duke i harruar ato derisa ato të mos ekzistojnë, dhe pastaj të largohet nga këto mendime me të menduar të balancuar.

Së dyti: Kërkoni strehim në Allahun nga këto mendime të këqija dhe nga

shejtani i mallkuar.

Së treti: Ai duhet të thotë, besoj në Allahun dhe të Dërguarit e Tij.

Së katërti: Ai duhet të thotë: "Allahu është një. Allahu është i pavarur. Ai nuk lind e as që është i lindur. Askush s'është i krahasueshëm me Të", pështyjë në anë të majtë tri herë dhe thuaj, "Kërkoj strehim në Allahun nga shejtani i mallkuar."

*Konfuzioni në lidhje me çështjen e paracaktimit*

Prej atyre çështjeve, të cilat vazhdojnë të rishfaqen dhe lënë rininë të hutuar, është çështja e paracaktimit. Besimi në paracaktim është njëra prej shtyllave të Imanit, dhe Imani s'është i plotë pa të. Ky besim nënkupton se Allahu, i Cili është i pastër, e di se çfarë do të ndodhë dhe çka është paracaktuar për

qiejt dhe tokën, siç thotë Allahu: **“A nuk e dini se Allahu e di tërë atë që është në qiell dhe në tokë? Vërtet, e tëra është e regjistruar dhe kjo është lehtë për Allahun.”** [22:70]

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, na ka parandaluar nga grindja dhe të debatuarit në çështjen e paracaktimit. Duke e parë këtë, ai u hidhërua derisa fytyra e bekuar e tij u skuq nga zemërimi. Pastaj, ai tha: **“A ju kam urdhëruar unë që ju ta bëni këtë?! A është kjo për të cilën unë jam dërguar te ju?! Popujt para jush janë shkatërruar kur debatuan për këtë çështje. Unë marr vendim të qëndrueshëm nga ju se ju s’do të grindeni në këtë çështje.”** (Hadith)

Tërheqja e vetvetes dhe grindja në çështjen e paracaktimit e çon njeriun në atë, prej të cilës ai s’ka mundësi të

dalë. Shtegu i shpëtimit është ai se ju duhet të keni dëshirë që të bëni mirë dhe të përpiqeni në bamirësi ashtu siç jeni urdhëruar, sepse Allahu, i Cili është i dëlirë, ju ka dhënë intelekt dhe të kuptuar, dhe ka ju ka dërguar të Dërguar dhe ka shpallur me ta. Allahu Te'ala thotë, **“Ashtu që njerëzimi, pas ardhjes së të Dërguarve të mos ketë dëshmi kundër Allahut. Allahu është i Urtë dhe i Lartësuar në Fuqi.”** [4:165]

Kur Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, i informoi shoqëruesit e vet se s'ka person përveç se t'i jetë paracaktuar vendbanimi në Xhenet dhe Xhehenem, ata thanë, “O i Dërguar i Allahut, a s'duhet që ne të varem në librin tonë (paracaktimin) dhe t'i lëmë veprat e mira.” Pejgamberi, sallallahu alejhi ue selam, u përgjigj: “Bëni vepra të mira, se çdo

gjë është lehtësuar për atë që është krijuar. Ata të cilët janë nga njerëzit fatlumë, veprat e njerëzve fatlum do t'u lehtësohen atyre ata që janë prej njerëzve fatkëqij, veprat e njerëzve fatkëqij do t'u lehtësohen atyre." Pastaj, i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selam, lexoi vargun: **"Ai i cili jep lëmoshë dhe frikohet (Allahut), dhe me tërë sinqeritetin e tij dëshmon për të mirën, Ne vërtet do ta bëjmë të këndshme për të rrugën për në lehtësim. Por ai i cili është lakmitar koprrac dhe e mendon veten si te vetë-mjaftueshëm dhe mohon Zotin, Ne vërtet do ta lehtësojmë rrugën e tij për në mjerim."** [92:5-10]

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, i urdhëroi ata që të bëjnë vepra të mira dhe nuk i lejoi ata që të varen në paracaktimin e tyre, sepse ata që janë paracaktuar të jenë nga njerëzit e

Xhenetit s'do të jenë në mesin e tyre, përveç nëse bëjnë vepra të njerëzve të Xhenetit, dhe ata të cilët janë paracaktuar që të jenë nga njerëzit e Xhehenemit s'do të jenë nga mesi i tyre, përveç nëse i bëjnë veprat e tyre. Vepra është sipas aftësisë së personit, sepse ai vetë e di se Allahu i ka dhënë zgjedhje në bërjen e veprës dhe e ka paracaktuar atë për të. Nëse ai do, ai mund ta bëjë apo ta lë atë.

Nëse njeriu ka për qëllim të udhëtojë, atëherë ai do të udhëtojë dhe nëse ai synon ndaljen, atëherë ai do ta bëjë këtë. Nëse ai sheh zjarr, ai do të ikë prej tij dhe nëse ai sheh një gjë e cila është e dashur për të, ai do të shkojë përpara. Ngjashëm është edhe në lidhje me dëgjueshmërinë dhe mëkatin; personi i bën ato me zgjedhjen e vet dhe i lë ato me zgjedhjen e vet.



Ekzistojnë dy vërejtje për disa njerëz në lidhje me çështjen e paracaktimit:

Së pari: Njeriu e sheh se ai bën diçka me zgjidhjen e vet dhe ai i lë të gjitha veprat me zgjidhjen e vet pa ndier ndonjë detyrim gjatë bërjes apo lënies së një veprë. Pra, si përkon kjo me besimin se çdo gjë është me vendimin dhe paracaktimin e Allahut?

Përgjigja ndaj kësaj është se nëse ne sodisim mbi veprën dhe lëvizjen e njeriut, ne do të shohim se kjo është rezultat i dy gjërave – qëllimit d.m.th. zgjedhjes për të bërë diçka, dhe mundësisë. Nëse këto dy gjëra s'gjenden, vepra s'do të ndodhë. Qëllimi dhe mundësia janë krijesa të Allahut, i Cili është më i Dëliri, sepse qëllimi është rezultati i fuqisë së mendjes dhe mundësia është rezultat i fuqisë së trupit. Nëse do Allahu, ai mund ta rrëmbejë mendjen e njeriut

dhe ai do të mbetej pa ndonjë qëllim, apo ta rrëmbejë prej tij mundësinë e tij duke e bërë kështu veprën të pamundshme për të. Kur njeriu e forcon qëllimin për të bërë një vepër dhe ai e ekzekuton atë, dituria jonë me bindje është se Allahu ka patur për qëllim dhe e ka paracaktuar atë vepër, përndryshe qëllimi i tij do të ndryshohej apo do të gjente ndonjë pengesë në mes vetes dhe mundësisë për ta zbatuar atë vepër. Një Beduin që pyetur, “Si e njeh Allahun?” Ai u përgjigj, “Me thyerjen e qëllimit të fortë dhe ndryshimin e vendimeve.”

Vërejtja e dytë: e cila rishfaqet, sipas disa njerëzve, në çështjen e paracaktimit është ajo se njeriu do të dënohet për veprat mëkatore të tij. Si mund të dënohet ai për këtë kur kjo i është paracaktuar atij dhe s’është e mundur për të që të ikë nga diçka e

cila është paracaktuar për të? Nuk është e drejtë që paracaktimi të bëhet argument për mosbindje derisa nuk bëhet argument për dëgjueshmëri. Përgjigja e dytë është ajo se Allahu e ka mohuar këtë argument në Kur'an dhe e ka kategorizuar atë si thënie injorante. Kështu, Allahu Te'ala thotë, **"Së shpejti idhujtarët do të thonë, sikur të kishte dashur Allahu, ne s'do t'i kishim përshkruar ortak Allahut, as që do ta kishin bërë këtë baballarët tanë, e as që do të ndalonim ndonjë gjë. Mu në këtë mënyrë argumentonin edhe paraardhësit e tyre, derisa e shijuan hidhërimin Tonë. Thuaj, a keni ju ndonjë dituri (të caktuar)? Nëse po, parashtrojeni atë. Ju nuk ndiqni tjetër përveç supozim, dhe ju vetëm gënjeni."** [6:148]

Allahu Te'ala ka shpjeguar se këta kundërshtues të paracaktimit i kanë në radhët e veta edhe ata që qenë para tyre, të cilët përgënjeshtroan (të Dërguarit) në mënyrën të cilën këta njerëz përgënjeshtrojnë (Pejgamberët), dhe ata mbetën të vendosur në këtë vepër të tyre derisa e shijuan dënimin e Allahut. Sikur dëshmia e tyre të ishte korrekte, Allahu s'do t'i bënte që ta shijojnë dënimin e Tij. Pastaj, Allahu urdhëroi të Dërguarin e Tij që t'i sfidojë ata që t'i vërtetojnë besimet e tyre dhe t'u shpjegojnë atyre se ata s'kanë asnjë dëshmi për këtë.

Përgjigja e tretë është ajo se paracaktimi është sekret i fshehtë. Askush nuk di për të përveç Allahut derisa të ndodhë. Si mund të ketë mëkatari dituri për tekstin të cilin Allahu e ka paracaktuar për të derisa e bën atë? S'është e mundur që Allahu

të ketë paracaktuar mosbindje për të?  
Pse pra ai shkon drejt mëkatit në vend  
që të shkojë drejt dëgjueshmërisë dhe  
të thotë se Allahu përfundimisht ka  
paracaktuar për mua që unë t'i  
bindem Atij?

Përgjigja e katërt është ajo se Allahu e  
ka bekuar njeriun me atë që i ka dhënë  
atij nga inteligjenca dhe të kuptuarit,  
dhe i ka shpallur atij libra dhe i ka  
dërguar të Dërguar, dhe ia ka  
përmbledhur atij atë që është e  
dobishme dhe atë që s'është e  
dobishme dhe e bekoji atë me qëllim  
dhe mundësi, me të cilat ai ka fuqi që  
ta përshkojë cilëndo rrugë. Pra, pse ky  
mëkatar zgjodhi shtegun e dëmit mbi  
shtegun e dobisë?

Nëse ky mëkatar ka patur për qëllim  
që të udhëtojë në një vend tjetër dhe ai  
i ka pasur dy rrugë që t'i zgjedh: njëra

është e lehtë dhe e rehatshme ndërsa tjetra e vështirë dhe e frikshme, ai definitivisht do ta përshkonte rrugën e lehtë dhe të rehatshme, e jo rrugën e vështirë dhe të frikshme për shkak të argumentit se Allahu e kishte paracaktuar atë për të. Sikur ai ta përshkonte rrugën e vështirësisë dhe ta përdorte argumentin se Allahu e ka paracaktuar atë për të, njerëzit do të mendonin për të se është naiv dhe i çmendur. Në të njëjtën mënyrë janë edhe rrugët e të mirës dhe së keqes. Njeriu do ta përshkojë rrugën e së mirës dhe s' do ta mashtrojë veten duke e përshkuar rrugën e së keqes me pretekstin se Allahu e ka paracaktuar atë për të. Ne shohim se secili person ka mundësi që ta përfitojë jetesën e tij. Ne shohim se ai përshkon çdo rrugë në përfitimin e jetesës. Ai nuk ulet në shtëpinë e tij dhe ta lë mësimin, duke u arsyetuar

me paracaktim.

Përndryshe, çfarë është dallimi në mes përpjekjes për këtë botë dhe përpjekjes në dëgjueshmërinë e Allahut? Pse e bëni paracaktimin hyjnor dëshmi për vetveten në lënien e dëgjueshmërisë, dhe ju nuk e bëni atë dëshmi për lënien e veprave që i takojnë kësaj bote? Sqarimi i argumentit është në vendin e vet por dëshirat e bëjnë personin të verbër dhe të shurdhër.

## **Hadithet në të cilat përmendet rinia**

Meqë këto fjalë vërtiten rreth problemit të rinisë, unë kisha dashur që të përmend disa hadithe në të cilat përmendet rinia. Nga mesi i tyre janë:

“Zoti yt është i kënaqur me atë

adoleshent i cili është i lirë nga pasioni rinor.” (Transmetuar nga Ahmed)

“Janë shtatë person të cilëve Allahu do t’u ofrojë hije prej hijes së Tij në ditën kur s’do të ketë hije tjetër përveç hijes së Tij. Sunduesi i drejtë; i riu i cili qe edukuar në dëgjueshmëri ndaj Allahut; njeriu, zemra e të cilit është e lidhur për xhaminë; dy njerëz të cilët e duan njëri-tjetrin vetëm për hir të Allahut dhe ata takohen për hir të Allahut; njeriu i cili nxitet nga një grua me pozitë dhe bukuri dhe ai thotë, “Unë i frikohem Allahut.”; njeriu i cili ka dhënë lëmoshë fshehtazi, saqë dora e tij e majtë nuk e di se çfarë ka dhënë dora e djathtë e tij; dhe personi i cili e përkujton Allahun në vetmi dhe lotët rrjedhin nga sytë e tij (për shkak të frikës ndaj Allahut).” (Transmetuar nga Buhari dhe Muslim)

“Hasani dhe Huseini (radiallahu



anhuma) do të jenë udhëheqësit e të rinjëve në xhenet.” (Transmetuar nga Tirmidhi)

“Do t’u thuhet njerëzve të Xhenetit: Për juve është rinia dhe ju kurrë s’do të plakeni.” (Transmetuar nga Muslim)

“Asnjëherë një i ri nuk e nderon një të vjetër për shkak të moshës së vjetër të tij, e që Allahu mos t’ia caktojë dikë i cili do ta nderojë atë gjatë pleqërisë së tij.” (Transmetuar nga Tirmidhi me zinxhir të dobët të transmetimit).

Ebu Bekr i tha Zejd bin Thabitit derisa Umeri ishte krahas tij (radiallahu anhum): “Ti je një i ri, inteligjent. Ne s’dyshojmë në ty dhe ti e shkruaje shpalljen për të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ue selam. Pra, ndiqe Kur’anin dhe mbledhe atë” (Transmetuar nga Buhari)

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, i erdhi një të riu derisa ai ishte në agoninë e vdekjes dhe e pyeti atë, “Në çfarë gjendje e sheh veten?” Ai tha, “Kam shpresë në Allahun, O i dërguar i Allahut dhe frikësohem për mëkatet e mia.” Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, tha, “Nuk bashkohen këto dy gjëra (shpresa dhe frika) në zemrën e robit në një moment të këtillë, e që Allahu mos t’ia jep atë për çka shpreson dhe ta shpëtojë atë nga ajo prej të cilës frikohet.” (Transmetuar nga Ibn Maxhe)

Bera bin Azib (radiallahu anhu) tha në lidhje me betejën e Hunejnit, “Jo, pasha Allahun, Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, nuk ka ikur, por madje edhe shoqëruesit e tij të rinj, të cilët qenë të lodhur dhe të pajisur dobët, u shfaqën për të luftuar.” (Transmetuar

nga Buhari)

Ibn Mes'ud (radiallahu anhu) transmeton, "Ne luftonim me Pejgamberin, salallahu alejhi ue selam, ndërsa ishim të rinj." (Transmetuar nga Ahmed)

Enes ibn Malik (radiallahu anhu) transmeton: "Kanë qenë shtatëdhjetë të rinj nga mesi i Ensarëve, të cilët janë quajtur *Kurra* (lexuesit), të cilët qëndronin në Xhami. Kur afrohej mbrëmja, ata tërhiqeshin te një kënd në Medine, ku ata mësonin njëri-tjetrin dhe faleshin. Familjet e tyre kishin përshtypjen se ata ishin në xhami dhe njerëzit e xhamisë kishin përshtypjen se ata ishin me familjet e tyre, deri në agim. Ata sillnin ujë të freskët dhe mblidhnin dru për zjarr, të cilin ata e ndiznin në dhomën e Pejgamberit, salallahu alejhi

ue salam.” (Transmetuar nga Ahmed). Me këtë ata blinin ushqim për As'habul Sufe (njerëzit e platformës). Njerëzit e platformës ishin varfanjakët, të cilët migruan në Medine. Ata s'kishin familje në Medine, kështu që ata strehoheshin te platforma në xhami.

Alkame, i cili është njëri nga Shoqëruesit e Ibn Mes'udit, (radiallahu anhu) transmeton, “Unë ecja me Abdullahun në Mine kur ai e takoi Uthmanin (radiallahu anhu). Abdullahu qëndroi duke biseduar me Uthmanin (radiallahu anhu) kur ai tha, “O Ebu Abdir-Rahman, a do të martojmë ty me një vajzë të re, ashtu që ajo do t'i përkujtonte ty disa gjëra të cilat kanë kaluar gjatë kohës tënde.” Abdullahu tha: “Nëse e thoni këtë, me siguri Resulullahu, salallahu alejhi ue salam, na ka treguar neve, “O rini,

kushdo nga ju që ka mundësi, le të martohet, sepse kjo është më efektive në mbrojtjen e shikimit dhe më e dëlirë për vendet e turpshme. Nëse dikush s'ka mundësi që ta bëjë këtë, atëherë ai duhet të agjërojë, sepse kjo është mburojë për të (nga mëkatet).” (Transmetuar nga Buhari dhe Muslim).

Në hadithin që ka të bëjë me Dexhallin, të transmetuar nga Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, “Dexhalli do ta thërrasë një person, i cili është në kulmin e rinisë së tij dhe do ta godasë atë me shpatë, duke e prerë atë në dy pjesë, sikur goditja e shënjestrës. Pastaj, Dexhalli do ta thërrasë të riun. I riu do të përgjigjet, duke qenë fytyra e tij vezulluese – duke qeshur.” (Transmetuar nga Muslimi)

Malik bin Huvejrith (radiallahu anhu) transmeton, “Ne erdhëm te Pejgamberi, salallahu alejhi ue salam, derisa ishim të rinj me moshë të ngjashme. Ne qëndruam pranë tij për njëzet ditë dhe netë. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue salam, ishte i mëshirshëm dhe i butë. Kur ai supozoi se ne mërziteshim për familjet tona në vështirësi, ai na pyeti neve se çfarë kishim lënë prapa, dhe ne e informuam. Pejgamberi, salallahu alejhi ue salam, tha, “Kthehuni te familjet tuaja, jetoni me ta, mësoni ata, thirrni ata,” dhe ai përmendi edhe disa gjëra tjera. “Faluni ashtu siç më shihni mua duke u falur. Kur të afrohet koha e namazit, atëherë njëri prej jush duhet ta thërrasë thirrjen e namazit (ezanin) dhe më i vjetri nga mesi juaj le të udhëheqë në namaz.” (Transmetuar nga Buhari)

Lusim Allahun që të na japë dobi nga ky libër mësimor, dhe lavdërimet janë vetëm për Allahun, i Cili është Zoti i Gjithësisë. Allahu dërgoftë bekimet më të mira dhe paqen mbi Pejgamberin, salallahu alejhi ue selam, dhe mbi të gjithë familjen dhe shoqëruesit e tij.

## **Përmbajtja**

Hyrje.....	2
Një vështrim i shkurtër në rininë.....	7
Lloji i parë.....	7
Lloji i dytë.....	19
Lloji i tretë .....	21
Devijimi i rinisë dhe problemet e tyre .....	24
Kotësia: .....	25
Largimi dhe ftohja në mes rinisë dhe anëtarëve të vjetër të familjes apo në mes rinisë dhe të tjerëve:.....	26
Bashkimi me njerëz të devijuar e të prishur dhe shoqërimi me ta. ....	28
Leximi i retorikës, broshurave dhe revistave të cilat krijojnë dyshim në fenë e personit dhe në besimet e tija. .....	30
Përshtypja e disa të rinjve se Islami	



është shkurtim i lirisë dhe përmbajtje e forcës. ....	32
Konfuzioni në lidhje me çështjen e paracaktimit .....	43
Hadithet në të cilat përmendet rinia	54